

Lëshimi i kartës së identitetit (mbi 16 vjeç).

Përshkrimi

Pajisja e shtetasve shqiptarë me kartë identiteti bëhet mbi moshën 16 vjeç.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Certificate familjare dhe/ose
- 2) Pasaportë e modelit të vjetër dhe/ose
- 3) Leje për drejtim automjeti, model elektronik (model i ri) dhe/ose
- 4) Dokument tjetër i vlefshëm me fotografi lëshuar nga vendi pritës
- 5) Kuponi për kartën ose
- 6) Konferma për kryerjen e pagesës në llogarinë e përfaqësisë

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale dhe verifikimi i identitetit
- 2) Konfirmimi i të dhënave me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- 3) Marrja e fotos dixhitale
- 4) Skanimi dhe marrja e shenjave të gishtërinjve
- 5) Depozitimi i nënshkrimit elektronik
- 6) Rimarrja e shenjave biometrike për tërheqjen e ID

Tarifa e shërbimit dhe afati

- 1) Greqi, Itali :12 euro,
- 2) Bruksel: 16 euro,
- 3) Angli: 13 paund,
- 4) Zvicër: 18 franga,
- 5) SHBA: 18\$

Afati i shërbimit është 28 ditë pune.

Zyra

- 1) Ambasadat e RSH: Athinë; Romë; Londër; Bernë.
- 2) Konsullatat e Përgjithshme: Selanik; Milano.
- 3) Zyra konsullore: Nju Jork.

Shënime

Vlefshmëria e Kartave të identitetit është 10 vjet.

Nëse një shtetas ka bërë aplikimin për ID në Shqipëri dhe nuk e ka tërhequr dot për arsye të ndryshme, atëherë ai duhet të paraqitet në një nga përfaqësitë, të bëjë një deklaratë para konsullit për anulimin e aplikimit të bërë në Shqipëri dhe lejohet të aplikojë vetem pas marrjes së miratimit.